

UNITED NATIONS

United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo

**UNMIK****NATIONS UNIES**

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2000/16

4 korrik 2001

RREGULLORJA NR. 2001/16

**NDRYSHIM I RREGULLORES NR. 2000/16 PËR REGJISTRIMIN DHE PUNËN
E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë atij me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Regulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korik 1999, të ndryshuar, lidhur me autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të rregullimit të regjistrimit dhe punës së partive politike në Kosovë dhe çështjeve të tjera lidhur me të,

Me këtë ndryshon nenet 2, 3 dhe 5 të Rregullores nr. 2000/16 të UNMIK-it,

Rrjedhimisht, Rrregullorja do të ketë formulimin e mëposhtëm si të datës në të cilën kjo Rregullore hyn në fuqi:

RREGULLORJA NR. 2000/16**MBI REGJISTRIMIN DHE PUNËN E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë atij me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Regulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korik 1999, të ndryshuar, lidhur me autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të rregullimit të regjistrimit dhe punës së partive politike në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme

1.1. Kjo rregullore do të udhëheqë regjistrimin, veprimet dhe shpërbërjen e partive politike në Kosovë.

1.2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje partia politike është organizatë individësh të anëtarësuar të cilët bashkohen vullnetarisht në bazë të idesë së përbashkët, interesit apo mendimeve, me qëllim që të arrihet ndikim politik dhe që përfaqësuesit e tyre të zgjidhen në organet qeverisëse. Kjo rregullore nuk e cenon të drejtën e individëve për bashkim të lirë.

Neni 2 Regjistrimi

2.1 Partia politike mund të parashtrojë kërkesë për regjistrim në Departamentin për Qeverisje Demokratike dhe Shoqëri Civile (më tej “Departamenti”) në mënyrë që të veprojë si person juridik në Kosovë.

2.2. Partia politike e bën kërkesën për regjistrim duke dorëzuar në Departament formularin e kërkesës, instrumentin e themelimit dhe statutet e saj dhe një pagesë në shumë prej 500 DM. Kjo pagesë do të depozitohet në Fondin e Konsolidimit të Kosovës. Formulari i kërkesës duhet të përfshijë të dhënat vijuese me shkrim:

- a) emrin zyrtar, shkurtesën dhe simbolin e partisë politike;
- b) emrat, datat dhe vendet e lindjes, adresat dhe informatat tjera kontaktuese dhe nënshkrimet e antarëve të organeve më të larta ekzekutive të partisë politike;
- c) adresat dhe numrat e telefonave të të gjitha zyreve të partisë politike;
- ç) statutin e partisë politike;
- d) programin politik të partisë politike të miratuar nga organi i saj më i lartë ekzekutiv, ku sqarohen qëllimet politike dhe veprimtaritë e partisë politike dhe i cili duhet të përfshijë në veçanti zotimin për respektimin e parimeve demokratike, mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut si dhe pohimin për respektim, tolerancë dhe mirëkuptim ndaj të gjithëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike;

2.3. Kërkesat për regjistrim duhet të shoqërohen me një formular të përkrahësve për regjistrim, i cili do të përfshijë emrat, datat dhe vendet e lindjes së tyre, adresat dhe nënshkrimet e përkrahësve të partisë politike që kërkojnë regjistrimin, të cilin formular Departamenti do ta ruajë në mënyrë konfidenciale. Formularët e zbrazët të përkrahësve të regjistrimit mund të merren në Departament.

2.4. Numri minimal i nevojshëm i përkrahësve të regjistruar për një kërkesë valide për regjistrim duhet të jetë 500.

2.5. Përkrahësit nuk mund të regjistrohen për përkrahje të më shumë se një partie politike. Përkrahësit që figurojnë në më shumë se një formular regjistrimi nuk mund të

llogaritën për qëllim të plotësimit të kufirit të nevojshëm kualifikues të paraparë në nenin 2.4 të kësaj rregulloreje.

2.6. Partia politike duhet ta informojë Departamentin brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë pune për çfarëdo ndryshimi material që ka të bëjë me dokumentet e paraqitura për regjistrim. Korrigjimet e kërkesave për regjistrim u nënshtrohen procedurave, standardeve dhe kufizimeve të njëjta kohore që vlejnë për kërkesat fillestare të regjistrimit.

2.7. Kërkesat për regjistrim do t'i publikojë Departamenti në pajtim me një udhëzim administrativ të cilin e lëshon Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Kushdo që dëshiron ta kundërshtojë regjistrimin e ndonjë partie politike, në bazë të cilësdo dispozitë të kësaj rregulloreje, mund t'ia paraqesë vërejtjet me shkrim Departamentit (bashkë me informatat apo materialin që e mbështet kundërshtimin), brenda 14 ditësh pas dorëzimit të kërkesës.

2.8. Departamenti do t'i shqyrtojë kërkesat e regjistrimit të partive politike në dritën e të drejtës së votimit dhe kritereve të tjera për regjistrim të partive politike sipas kësaj rregulloreje.

2.9. Departamenti do ta njoftojë me shkrim partinë politike për pranimin apo refuzimin e kërkesës për regjistrim brenda dy (2) muaj ditësh pas pranimit të kërkesës për regjistrim, përveç nëse Departamenti kërkon me shkrim informata plotësuese apo sqarime.

2.10. Për kërkesat me shkrim të Departamentit, lidhur me informatat apo sqarimet e mëtutjeshme lidhur me kërkesën e regjistrimit, duhet pagur një taksë për periudhën prej dy (2) muaj ditësh të cekur në nenin 2.9. të kësaj rregulloreje.

2.11. Çfarëdo vendim i Departamentit lidhur me refuzimin e regjistrimit të partisë politike do të shqyrtohet automatikisht nga Komisioni Shqyrtues që përbëhet prej së paku tre (3) anëtarëve, të cilët do të emërohen nga ana e Zyrës së PSSP-së dhe zyrat e ZPSSP-së për Administratë Civile dhe për Ndërtimin e Institucioneve, për të vërtetuar vlefshmërinë e refuzimit dhe respektimin e kësaj rregulloreje. Një votim i thjeshtë me shumicën e anëtarëve të Komisionit Shqyrtues mjafton për ta ndërruar vendimin e Departamentit. Partia politike do të njoftohet me vendimin e Komisionit Shqyrtues brenda afatit kohor të paraparë në nenin 2.10 të kësaj rregulloreje. Nëse regjistrimi refuzohet, Departamenti duhet të ofrojë sqarim për arsyet e refuzimit të regjistrimit. Partia politike mund t'i ankohet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me vendimin e refuzimit për regjistrim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e njohtimit për vendimin e Komisionit Shqyrtues.

2.12. Departamenti do ta mbajë regjistrin e partive të regjistruara politike. Regjistri duhet të përmbajë adresat dhe numrat e telefonave të të gjitha zyrave të partive politike, emrat, adresat si dhe informatat e tjera për kontaktim me antarët e organit më të lartë

ekzekutiv. Regjistrin mund ta ketë në dispozicion publiku në një vend qendror gjatë orëve të rregullta të punës të cilin do ta caktojë Departamenti.

Seksioni 3

Arsyet për refuzimin e regjistrimit

3.1 Departamenti mund ta refuzojë kërkesën për regjistrim të partisë politike nëse:

- (a) dokumentet e regjistrimit janë në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- (b) statutet apo programi politik i partisë politike shkelin cilëndo rregullore të UNMIK-ut apo dispozitat tjera të ligjit në fuqi;
- (c) partia politike që kërkon të regjistrohet është në kundërshtim me paragrafin 4.3 të kësaj rregulloreje;
- (ç) partia politike që kërkon të regjistrohet ka një emër, që sipas bindjes së Departamentit mund të nxisë urrejtje ose dhunë;
- (d) partia politike që kërkon të regjistrohet ka emër të njëjtë, apo shumë të ngjashëm me partinë tjetër politike të regjistruar më parë apo të themeluar rishtas, i cili mund të krijojë konfuzion. Departamenti do të vendosë se cila parti ka të drejtë ta përdorë emrin, duke marrë parasysh rrethanat në tërësi, siç është historia dhe data kur e ka dorëzuar partia kërkesën.

3.2. Departamenti mund ta pezullojë apo ta anulojë regjistrimin në rast të shkeljes së cilësdo dispozitë të kësaj rregulloreje. Përveç në rastet e shkeljeve serioze, që mund të paraqesin kërcënim ndaj qetësisë dhe rendit publik, Departamenti do ta njoftojë me shkrim partinë politike për shkeljen e bërë dhe për mundësinë që të përgjigjet para se të pezullohet apo të anulohet regjistrimi.

Neni 4

Udhëheqja e brendshme dhe organizimi i partive politike

4.1. Organi më i lartë vendimmarrës i një partie politike është kuvendi i anëtarëve. Kuvendin e anëtarëve e përbëjnë të gjithë anëtarët e partisë politike apo delegatët e tyre të zgjedhur, të cilët duhet të takohen së paku një herë në vit. Kuvendi i anëtarëve e ka përgjegjësinë përfundimtare për programin politik, politikën dhe çështjet financiare të partisë politike. Të gjitha vendimet do të mirren përmes procedurave demokratike

4.2. Partia politike do të zgjedhë nga anëtarët e saj organin ekzekutiv, duke e përfshirë kryetarin dhe zyrtarët e tjerë. Partia duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se kush është i autorizuar të nënshkruajë në emër të partisë për çështjet financiare dhe kush është përgjegjës për aktivitete dhe deklarata në emër të partisë politike. Organi ekzekutiv i

partisë politike do të zgjedhet nga kuvendi i anëtarëve së paku çdo të dytin vit. Organi ekzekutiv do të jetë përgjegjës për administrimin e partisë politike .

4.3. Asnjë person i akuzuar nga Gjygi Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi apo nga çfarëdo gjygi tjetër për krime lufte, të cilin mund ta themelojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, nuk mund të ushtrojë funksione emëruese, zgjedhore ose ta përfaqësojë partinë politike.

4.4. Anëtarët e organit ekzekutiv të partisë politike nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë partie tjetër politike. Gjyqtarët, prokurorët dhe zëvendësit e tyre, ombudsmenët dhe zëvendësit e tyre, pjesëtarët profesionalë të policisë dhe pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës nuk mund të jenë anëtarë të organit ekzekutiv të ndonjë partie politike.

Neni 5 Pasuria dhe burimet

5.1. Të ardhurat e partive politike mund të përfshijnë donacionet me para të gatshme, pagesat e anëtarësisë, subvencionet, dhuratat, dhurimet, trashëgimitë me testament, pronën e patundshme apo personale si dhe të ardhurat e krijuara nga cilido aktivitet i ligjshëm i partisë politike, i ndërmarrë me pasurinë dhe burimet e saj.

5.2. Partia e regjistruar politike duhet të përgatisë dhe t'ia dorëzojë Departamentit raportet vjetore financiare, që përmbajnë secilin apo të gjitha kontrbutet e bëra për partinë politike nga ndonjë burimi i vetëm që e tejkalon shumën e përgjithshme prej 3,000 DM gjatë cilësdo periudhë vjetore, të cilat raporte do t'i mbajë si dokumente Departamenti. dhe do t'i vihen publikut në dispozicion për vlerësim. Departamenti ruan të drejtën për të kërkuar, verifikuar, hetuar dhe, kur është e nevojshme, revokuar ose pezulluar statusin e regjistruar të partive politike që shkelin raportimin financiar dhe kushtet e veprimit të hapur, të përfshira në nenin 5.

5.3. Statutet e partive të regjistruara politike duhet të përfshijnë dispozitat e hollësishme në sistemin e raportimit të tyre financiar vjetor dhe kushtet e veprimit të hapur.

5.4. Partia e regjistruar politike nuk duhet të angazhohet në aktivitetet komerciale për kurrëfarë qëllimesh.

5.5 Partia politike nuk duhet të shpërndajë çfarëdo të ardhurash apo pasurish si të tilla te asnjë person. Pasuria dhe të ardhurat e një partie politike duhet të përdoren për të mbështetur qëllimet politike jofitimprurëse të partisë politike dhe nuk duhet të shfrytëzohen për të siguruar përfitime, drejtëpërdrejtë apo tërthortë, ndaj asnjë anëtarë të partisë politike, organeve të saj ekzekutive apo donatorin e partisë politike. Ky nen nuk

parandalon pagesën e kompenzimit të arsyeshëm për personat e tillë lidhur me punën e kryer për partinë politike.

5.6. Partia e regjistruar politike mund të posedojë dhe udhëheqë pasuri dhe mjete finaciare për realizimin e qëllimeve të saj joprofitabile politike.

Neni 6 Shpërbërja

6.1. Statuti i secilës parti duhet të përmbajë dispozita për shpërbërjen e partisë, e posaçërisht për shpërndarjen e fondeve dhe mjeteve pas shkarkimit nga përgjegjësia.

Neni 7 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 8 Ligji në fuqi

Kjo rregullore do të shfuqizojë çfarëdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që ka të bëjë me regjistrimin dhe punën e partive politike në Kosovë që është në kundërshtim me të.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore¹ hyn në fuqi më 4 korrik të vitit 2001.

(i nënshkruar)
Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

¹ Rregullorja origjinale ka hyrë në fuqi më 21 mars të vitit 2000.